



## Letër rekomandimi për Bursën e Ekselencës Akademike Dr. Jorgji Jajçari

Letrat e rekomandimit kërkohen shpesh për shumë aplikime të ndryshme. Qëllimi i tyre është që komisioni përzgjedhës të njohë sa më mirë aplikantët. Letra duhet shkruar nga një mësues/mentor që e njeh nxënësin nga afër prej një kohe relativisht të gjatë dhe duhet dërguar direkt nga mësuesi/mentori në adresën [bursajorgjijajcari@gmail.com](mailto:bursajorgjijajcari@gmail.com). Gjatësia e letrës duhet të jetë jo më shumë se 400 fjalë.

Eksperienca juaj me nxënësin është pjesë shumë e rëndësishme e letrës. Komisioni përzgjedhës kërkon të dijë si nxënësi punon në mënyrë të pavarur si dhe në grup. Ju mund të përmendni ndonjë ngjarje konkrete që nxjerr në pah një cilësi të caktuar të nxënësit. Përshkrimet duhet të përmbajnë sa më shumë detaje.

Potenciali i nxënësit është një pikë tjetër shumë e rëndësishme e rekomandimit. Në letër duhet të theksoni pikat e forta të nxënësit si dhe potencialin e tij/saj për sukses në të ardhmen. Ju duhet të përmendi performancën akademike dhe se si nxënësi i menaxhon detyrat sfiduese që i ngarkohen. Kjo i demonstroi komisionit se ju besoni tek aftësitë e nxënësit. Nëse është e nevojshme, letra duhet të përmbajë edhe një ose disa pika ku nxënësi ka mundësi të përmirësohet ose ku mund të punojë më tepër.



## Formati i letrës së rekomandimit

Emri Mbiemri

Titulli

Shkolla apo kompania

Adresa

Data

### Paragrafi i parë

Shpjegoni lidhjen tuaj me nxënësin, si jeni njohur, prej sa kohësh, si dhe pse mendoni se jeni personi i duhur për të shkruar një letër të tillë.

### Paragrafi i dytë

Ky paragraf duhet të përmbajë informacion mbi performancën e nxënësit, përfshirë arsyen se pse është i denjë për të qënë fitues i bursës. Kjo është pjesa më e rëndësishme e letrës prandaj duhen përfshirë të gjitha pikat e përmendura në faqen 1. Nëse është e nevojshme, këtu mund të shtoni edhe më shumë se një paragraf.

### Paragrafi i tretë

Këtu mund të bëni një përmbledhje të shkurtër në formë konkluzioni se pse kandidati që ju rekomandoni dallon nga të tjerët.

Për çdo pyetje ose informacion shtesë, mund të na kontaktoni në çdo kohë në adresën tonë të emailit [bursajorgjijajcari@gmail.com](mailto:bursajorgjijajcari@gmail.com). Faleminderit për kohën e kushtuar shkrimit të letrës së rekomandimit!

Me respekt,

**Stafi i Bursës së Ekselencës Akademike Dr. Jorgji Jajçari**